

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET PALËVE TË KONVENTËS SË BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EVROPËN JUGLINDORE, PËR SHKËMBIMIN E AUTOMATIZUAR TË TË DHËNAVE TË ADN-SË, DAKTILOSKOPIKE DHE TË TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT TË AUTOMJETEVE, DHE MARRËVESHJES SË SAJ ZBATUESE”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Më 13 shtator 2018, në Vjenë u nënshkrua marrëveshja, ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshja e saj zbatuese.

Palët e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (Republika e Shqipërisë, Republika e Austrisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Hungaria, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Rumania, Republika e Serbisë, Republika e Sllovenisë) me anë të këtij projektligji synojnë forcimin e bashkëpunimit policor ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm, duke luftuar kërcënimet e sigurisë publike për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale.

Ky projektligj përmban rregullat për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve. Me anën e shkëmbimit automatik të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, Shqipërisë i krijohet mundësia që të shfrytëzojë 10 bazat e të dhënave të shteteve të tjera që do të bëhen palë të projektligjit, duke i dhënë akses që të kontrollojë profilet e ADN-së, shenjat daktiloskopike dhe të dhënat e regjistrimit të automjeteve, si të shtetasve shqiptarë ashtu dhe profilet e ADN-së të ngjarjeve kriminale të ndodhura në Shqipëri, me qëllim identifikimin *on-line* të personave që janë përfshirë në këtë aktivitet kriminal apo kanë ndryshuar të dhënat e tyre identifikuese, emër, mbiemër etj.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është në përputhje me programin politik të qeverisë shqiptare, në kapitullin “Shteti i së drejtës dhe demokratizimi i shoqërisë/ krimi i organizuar, terrorizmi e trafikimi”.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ky projektligj pritet të kontribuojë në rritjen e efektshmërisë së strukturave ligjzbatuese në zbulimin dhe identifikimin e personave të përfshirë në aktivitet kriminal, nëpërmjet aksesit në bazat e të dhënave të vendeve të tjera.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Traktatin e 27 Maj-it 2005, ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës, Republikës Federale të Gjermanisë, Mbretërisë së Spanjës, Republikës Franceze, Dukatit të Madh të Luksemburgut, Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Austrisë, në përsheptimin e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe migrimit të paligjshëm”.

Në vitin 2008, Këshilli i Bashkimit Evropian, me vendimet 2008/615/JHA dhe 2008/616/JHA, për shkak të suksesit të këtij bashkëpunimi, adoptoi kuadrin *Prum* dhe e bëri pjesë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin drejtpërdrejt me *acquis*, por zbatimi i kuadrit *Prum* do të mundësojë që Shqipëria të avancojë dukshëm në zbatimin e kapitullit 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”.

Kuadri *Prum* u bë pjesë e legjislacionit të BE-së, me vendimin e Këshillit 2008/615/JHA të 23 qershorit 2008, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkufitar, vendimin e Këshillit 2008/616/JHA të 23 qershorit 2008, në zbatimin e vendimit 2008/615/JHA në nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkufitar.

### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Shkëmbimi automatik i të dhënave është një mjet efektiv për zbatimin e ligjit, si në luftën kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar ndërkufitar, ashtu edhe në luftën kundër terrorizmit.

Ky projektligj përmban rregullat për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të të dhënave daktiloskopike, të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, si dhe shkëmbimin e të dhënave personale në dispozicion.

Për mbështetjen e zbatimit të transmetimit dhe krahasimit të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve, palët përcaktojnë:

- Dispozitat mbi kushtet dhe procedurat për transferimin e automatizuar të profileve të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave për regjistrimin e automjeteve.
- Dispozitat e nevojshme administrative dhe teknike, për zbatimin e shkëmbimit të automatizuar të të dhënave të ADN-së, të të dhënave daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve.
- Me qëllim ofrimin e të dhënave personale dhe informacioneve të tjera të lidhura me të dhënat e referencës, çdo palë do të caktojë një pikë kombëtare kontakti. Për të siguruar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave që do të dërgohen te palët e tjera, do të merren të gjitha masat e nevojshme duke përfshirë dhe kriptimin e tyre.
- Për hetimin e veprave penale dhe për të ndihmuar në identifikimin e personave të humbur dhe mbetjeve njerëzore të paidentifikuara, palët me një pëlqim të përbashkët, nëpërmjet pikave të tyre kombëtare të kontaktit do të krahasojnë profilet e ADN-së, me të gjitha profilet e ADN-së të dosjeve të analizës së ADN-së kombëtare. Profilet do të ofrohen dhe do të krahasohen në një formë të automatizuar.
- Palët do të sigurojnë disponueshmërinë e të dhënave nga dosja për sistemet kombëtare të automatizuara të identifikimit të gjurmëve të gishtave, të përcaktuara për parandalimin dhe hetimin e veprave penale, si dhe për të ndihmuar në identifikimin e personave të humbur dhe të mbetjeve të paidentifikuara njerëzore. Të dhënat e referencës do të përfshijnë vetëm të dhënat daktiloskopike dhe një numër reference, duke mos ofruar asnjë të dhënë nga të cilat subjekti mund të identifikohet në mënyrë direkte.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e projektligjit është Ministria e Brendshme, për pjesën e të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të ADN-së.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për pjesën e të dhënave të regjistrimit të automjeteve.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, do të ketë detyra mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji iu dërgua për mendim Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në shkronjën “dh”, të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Në lidhje me kostot financiare për këtë projektligj, theksojmë se kosto shtesë duhet të planifikohen për implementimin e rrjetit të kriptuar TESTA që do të bëjë të mundur realizimin e sigurt të lidhjes fizike të dy sistemeve, atij CODIS dhe AFIS/APIS me sistemet respektive të të 10 shteteve anëtare të PCC SEE. Po kështu, kosto shtesë do të ketë dhe për shkëmbimin automatik të të dhënave të regjistrimit të automjeteve në sistemin EUCARIS.

Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.145/2014, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin në lidhje me Sistemin European të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit (EUCARIS)”, në këtë traktat.

Për sa i përket rrjetit TESTA, kostot e instalimit dhe mirëmbajtjes së këtij rrjeti do të varen nga sa institucione që lidhen me të. Rrjeti TESTA administrohet nga Komisioni Evropian dhe është një rrjet i sigurt dhe që ofron kriptim. Në vendet e BE-së përdoret për komunikimin e administratave dhe nga ministritë përgjegjëse për financat dhe drejtësinë.

Ashtu si në rastin e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore, palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë bazën ligjore të bashkëpunimit dhe të punojnë hap pas hapi mbi ngritjen e kapaciteteve për zbatim.

Gjithashtu, krahas marrëveshjes dhe marrëveshjes zbatuese, u nënshkrua dhe një memorandum mirëkuptimi mes ministrave të Brendshëm, me përmbajtje politike, i cili do të shërbejë për të aplikuar për financime nga donatorë të ndryshëm.

Ministria e Brendshme po punon me AKSHI-n për ngritjen e një grupi pune me objekt:

- a) të identifikohen të gjithë përdoruesit e mundshëm të TESTA-s;
- b) të identifikohet cili institucion do të jetë përgjegjës;
- c) të identifikohen sistemet që mund të zëvendësohen, duke e bërë të vlefshëm dhe në aspektin financiar.

Palët me hyrjen në fuqi të këtij projektligji, do të krijojnë vetëm bazën ligjore. Zbatimi i secilës nga pikat e marrëveshjes parashikon njoftime për secilin aspekt (gatishmërinë për të shkëmbyer të dhënat e regjistrimit të automjeteve, gatishmërinë për të shkëmbyer të dhënat e ADN-së dhe gatishmërinë për të shkëmbyer të dhënat daktiloskopike) dhe në fund të saj do të bëhet një vlerësim nga ekspertët e BE-së mbi plotësimin e kushteve të mbrojtjes të të dhënave.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**